



A.nr.328/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj–Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.328/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesja B.M, nga Gjakova, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim të datës 30.06.202, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.328/2026, e datës 24.03.2026, e parashtruar nga ankuesja B.M.
- II. Mbeten në fuqi** Njoftimi i datës 12.03.2026, i Komisionit të Pranimit, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas Konkursit të Jashtëm Nr.03/2025, të datës 12.11.2025.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, B.M. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 24.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 22.04.2026, kundër rezultateve përfundimtare të datës 12.03.2026, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, të shpallur sipas Konkursit të Jashtëm Nr.03/2025, të datës 12.11.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 07.04.2025, ka përcjellë përgjigjën në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë. *Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave* (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1458 të parashtruar nga ankuesja me datë

24.03.2026 në Këshill; Kopjen e Konkursit, për pozitën e punës “ Zyrtar/e Ligjore”; Listën e ngushtë të kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë procedurë rekrutimi; Vendimin për themelimin e Komisionit të vlerësimit DS.11/2026 të datës 12.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, së bashku me Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Testet me shkrim për kandidatet fitues; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë nga anëtarët e Komisionit; Njoftimin për rezultatin përfundimtar të datës 12.03.2026 Dosjen e kandidatit/palës ankuese në Këshill, sipas së cilës dëshmohet përvoja profesionale si dhe aftësitë tjera; Dosjet e kandidatëve të përzgjedhur sipas njoftimit përfundimtar, emaili i KPMSHCK-se i datës 09.06.2026 për SKGJK-në, dhe emali përgjigje e datës 09.06.2026, nga SKGJK-ja.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është ***e pabazuar, sepse:***

I. Gjendja e çështjes

Nga analizimi i provave të lëndës rrjedhë se:

- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 12.11.2025, ka shpallur Konkursin e Jashtëm Nr.03/2025, për nëntëdhjetë e katër (94) pozita pune, ashtu që në këtë konkurs për pozitën *Zyrtar Ligjor*, janë shpallur katër dhjetë e një (41) vende, gjegjësisht dy (2) pozita në Sekretariatin e KGJK-së, një (1) pozitë në Gjykatën Supreme të Kosovës, dy (2) pozita në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, dy (2) pozita, një (1)- komunitetin serb dhe një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar në Gjykatën e Apelit, katër (4) pozita 1- komunitetin serb në Gjykatën Komerciale, tetëmbëdhjetë (18) pozita, dy (2) prej tyre për komunitetin serb dhe një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar, në Gjykatën Themelore në Prishtinë; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Prishtinë- dega Lipjan; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Prishtinë- dega Graçanicë; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Gjilan; dy (2) pozita një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar, në Gjykatën Themelore në Pejë; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Gjakovë-dega Rahovec; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega Skenderaj; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega Vushtrri.

-Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 12.11.2025 deri më datë 11.12.2025, ndërsa, bazuar në Kërkesën për Punësim të datës 18.11.2025, rezulton se ankuesja ka aplikuar për pozitën *Zyrtar Ligjor* në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Komerciale dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe se e njëjta ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit duke arritur gjithsejtë 69.96 pikë, gjegjësisht 50.7 pika nga testi me shkrim dhe 19.26 pikë nga intervista me gojë, ashtu që sipas Rezultateve përfundimtare të vlerësimit nga testi me shkrim dhe intervista me gojë të datës 12.03.2026, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se e njëjta nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për tu shpallur kandidate fituese në asnjërën nga pozitat e aplikuara, rrjedhimisht në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, është renditur e katër dhjetë e tetë (48), ndërsa në Gjykatën Themelore në Prishtinë është renditur e nëntëdhjeta (90), kurse në Gjykatën e Apelit ankuesja nuk ishte përfshirë në listën e ngushtë pasi që konkursi për këtë gjykatë ka qenë i hapur vetëm për komunitet jo shqiptare gjegjësisht një vend për komunitetin serb dhe 1 vend për komunitet tjera jo shumicë.

-Rrjedhimisht, sipas Rezultateve përfundimtare të datës 12.03.2026, nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se kandidatet fitues për pozitën e punës Zyrtar Ligjor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme janë: Gentiana Krasniqi me gjithsej 83.68 pikë dhe Zana Ismajli me gjithsej 79.9 pikë.

-Sipas Rezultateve përfundimtare të datës 12.03.2026, nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se kandidatet fitues për pozitën e punës Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë fitues: D.K me gjithsej 87 pikë; Z.K me gjithsej 85.8 pikë; T.H. me gjithsej 81.7 pikë; E.A me gjithsej 80.64 pikë, E.H me gjithsej 80.6 pikë; E.B me gjithsej 80.2 pikë; B.G. me gjithsej 79.86 pikë; L.RR me gjithsej 79.86 pikë; A.R. me gjithsej 79.1 pikë; F.A. gjithsej 78.9 pikë; L.M-SH me gjithsej 78.2 pikë; A.Ç. me gjithsejtë 78.1 pikë; J.R-I me gjithsej 77.54 pikë; M.G me gjithsej 77 pikë; T.J. me gjithsej 76.98 pikë.

II. *Pretendimet ankimore*

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në procesin e vlerësimit të testit me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive. Kërkon që të shqyrtohet ankesa në mënyrë të plotë dhe objektive, qasje në testin me shkrim vlerësimin dhe arsyetimin përkatës si dhe të ndermirën veprimet e nevojshme në rast se konstatohet së ka pasur parregullsi gjatë procesit.

III. *Vlerësimi i Kolegjit*

Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratën e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Gjyqësor me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion gjegjësisht me Rregulloren Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit për pozitën *Zyrtar Ligjor*, klasa profesional 2, të shpallur sipas Konkursit nr.03/2025, të datës 12.11.025, dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: -**Arsimi i kërkuar:** *Diploma universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik;* -**Përvoja e punës e kërkuar:** *Së një (1) vit përvojë pune*

profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referuar nenit 3, 7, 17, 19, 20, 22, dhe 23 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me të cilat dispozita përcaktohet se :

- Nenin 3,[Parimet për pranim]: *Pranimi në detyrë i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor bazohet në procedurë të hapur dhe konkurruese duke siguruar profesionalizëm, integritet, mos-diskriminimin, transparencës, pavarësinë, paanshmërinë, meritokracinë, si dhe të pasqyroj natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme të Republikën e Kosovës.*
- Nenin 7, [Komisioni i Pranimit]: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve për emërim në një pozitë të kategorisë profesionale behët nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për kategoritë profesionale ka pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtareve të komisionit caktohet një anëtarë zëvendësues, në këtë përbërje: 2.1 tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues apo të ulet drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi ku njëri nga ta caktohet Kryetar i Komisionit; 2.2. një (1) përqafueses nga NJMBNJ; dhe 2.3 një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse për të cilën zhvillohet konkurrimi.*
- Nenin 17 ,[Vlerësimi profesional i kandidatëve]: *1.Vlerësimi profesional i kandidatëve, zhvillohet nga komisioni i pranimit dhe përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 2.Vlerësimi profesional i kandidatëve zhvillohet në dy faza : 2.1. Faza e parë: vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim; dhe 2.2. Faza e dytë: vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë....,*
- Nenin 19, [Testi me shkrim] :*1.Testi me shkrim, përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje me përgjigje të shumëfishtë me një përgjigje të saktë prej të cilave: dhjetë (10) pyetje nga njohuritë e përgjithshme institucionale dhe pesëmbëdhjetë (15) pyetje me njohuri që lidhen me vendin e punës dhe katër (4) ese të shkurtra, me maksimum njëqind (100) fjalë, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara për pozitën e shpallur. 2. Secila përgjigje e saktë e pyetjeve me përgjigje të shumëfishtë nga testi me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlerësohet me një pikë gjatë (1.6) pikë dhe në këtë pjesë kandidati mund të fitojë dyzet (40) pikë, ndërsa eset mund të vlerësohet me tridhjetë (30) pikë apo secila ese më se shumti me nga shtatë pikë pesë (7.5) pikë. 3.Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4.Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.....*
- Nenin 20 [Vlerësimi i testit me shkrim], ku përcaktohet se: *1.Vlerësimin e testit me shkrim e bënë komisioni i pranimit dhe atë më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e mbajtjes së provimit, përveç rasteve kur kemi numër të madh të testeve për të vlerësuar dhe kjo duhet arsyetuar me shkrim nga kryetari i komisionit. 2.Komisioni në ditën kur fillon vlerësimi hap pakon ku gjenden plikot e formatit A-4 dhe vlerëson testin me shkrim në bazë të kodit të shënuar në plikon A-4 në të cilën ndodhet testit pa ditur të dhënat e kandidatit. 3.Komisioni do të diskualifikojë secilin test i cili mund të ketë një shenjë identifikuese të bërë me qëllim. 4.Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, për të gjitha kategoritë, vlerësohen duke u bazuar në saktësinë e përgjigjes dhe duke fituar numrin e pikëve për secilën pyetje ashtu siç është përcaktuar në nenin 19 paragrafi 2, varësisht nga kategoria e pozitës për të cilën është mbajtur testi. 5.Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e komisionit të pranimit në mënyrë individuale dhe mbledhja e pikëve të secilit anëtar të komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e komisionit. 6.Vlerësimi minimal apo maksimal i esesë duhet të arsyetohet me shkrim nga vlerësuesi.*

7.Shuma e pikëve të vlerësuara nga paragrafi 4 dhe 5 përbën vlerësim përfundimtar të testimit me shkrim për një kandidat.... 8.Formularët e vlerësimit të cilët janë të identifikuar si kod plotësohen dhe nënshkruhen nga komisioni i pranimit dhe bashkohen me plikot e formatit A-4 që përmban të njëjtin kod.

- Nenin 22 [Vlerësimi i kandidatëve përmes intervistës me gojë],: 1. Pas vlerësimit të testi me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 3.Intervista zhvillohet nga komisioni i pranimit i cili përgatit apo përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon SMDEAGj (kur e njëjta të jetë funksionale), dhe pyetjet duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët të cilët intervistohen brenda një dite. 4.Përveç pyetjeve, anëtarët e komisionit të pranimit mund të parashtrojnë nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 5.Intervista për të punësuarit në kategorinë profesionale dhe kategorisë staf teknik dhe mbështetës përmban pesë (5) pyetje, kryesisht rreth pozitës për të cilën intervistohet, ku secila vlerësohet me më së shumti pesë (5) pikë.....7.Secili nga anëtarët e komisionit të pranimit bënë vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe për secilin rast të vlerësimit minimal apo maksimal duhet të jep arsyetim me shkrim. 8.Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre (5) janë për jetëshkrimin (CV). 9.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 9.1.deri në dy pikë (2.5) pikë për përvojën relevante në punë më të gjatë se sa ajo që është kërkuar me konkurs; dhe 9.2.deri në dy pikë (2.5) pikë për trajnimet relevante në fushën përkatëse. 10.Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve të komisionit të pranimit....

- Nenin 23, [Shpallja e rezultatit përfundimtar]: 1.Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshinë shumën e pikëve të fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. 2.Në përfundim të vlerësimit, komisioni i pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve emrin dhe mbiemri, numrin total të pikëve të fituara e cila është shuma e pikë të fituara gjatë intervistës me shkrim dhe me gojë dhe kandidati fitues konsiderohet kandidati i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pakë se shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale të vlerësimit. 2. të gjithë kandidatët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 2.2.lista e kandidatëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNJ, si dhe në faqen zyrtare të Këshillit..... ”

Referuar kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar së kriteret e përgjithshme formale lidhur me pozitën e kontestuar janë në pajtim më nenin 27 të Rregullores Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e plotësuar dhe ndryshuar më nenin 17 të Rregullores nr.24/2024, ndërsa, përbërja e Komisionit të Pranimit i themeluar sipas Vendimit DS.11/2026 të datës 12.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, është në pajtim më kërkesat ligjore të përcaktuara më nenin 7 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Tutje, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se testi me shkrim në procedurën e kontestuar është hartuar në formatin e kërkuar sipas nenit 19 të Rregullores Nr.01/2024, gjegjësisht, pjesa e parë lidhur me njohuritë e përgjithshme institucionale, ka përfshirë 10 pyetje me zgjidhje të shumëfishtë, pjesa e dytë e testit përkritazi me njohuritë lidhur me vendin e punës ka përmbajtur gjithsej 15 pyetje me zgjidhje të shumëfishtë, dhe pjesa tretë e testit që ka të bëjë me ese ka përmbajtur 4 ese të shkurtra. Ndërsa, Kolegji i Këshillit nga analizimi i testit me shkrim të ankueses tek Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka arrit në total 50.7 pikë, dhe si

rrjedhojë në kuptim të paragrafit 4 të nenit 19 të Rregullores Nr.01/2024, e njëjta ka kaluar pragun e kalueshmërisë së testit me shkrim dhe ka fituar të drejtën për pjesëmarrje në intervistën me gojë, dhe se nga shqyrtimi i shkresave rezulton se ankuesja është vlerësuar nga anëtarët e Komisionit të Pranimid lidhur me përgjigjet në pyetjet e parashtruara më 19.26 pikë, tek fusha e përvojës së punës është vlerësuar me 2.5 pikë maksimale, ndërsa tek fusha e trajnimeve është vlerësuar me 0 pikë. Kështu që, nisur nga kjo gjendje faktike, Kolegji i Këshillit bazuar ne provat e parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimit nuk ka rritur të argumentoj faktin nëse ka pas vlerësim jo të drejt në raport me ankuesen.

Po ashtu, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidateve fituese (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), duke konstatuar këtë gjendje faktike:

I. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

-Kandidatja G.K. posedon Diplomën me numër 249, të datës 16.09.2016, për përfundimin e studimeve themelore më datë 07.09.2016, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Ukshin Hoti”, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës ka proceduar si dëshmi Certifikatën e datës 31.03.2023, të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, për përfundimin e praktikës gjyqësore pranë kësaj gjykatë, në periudhën kohore nga 01.04.2022 deri 31.03.2023.

-Kandidatja fituese Z.I. posedon Diplomën me numër 3593, të datës 22.12.2015, për përfundimin e studimeve themelore më datë 06.09.2013, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasa Prishtina”, kurse, ndërlidhur më përvojën e punës, ka bashkangjitur si provë Vërtetimin e datës 09.12.2025, të lëshuar nga Administratorja e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, më të cilin konfirmohet së kandidatja në fjalë nga data 01.06.2023 është e punësuar në pozitën Zyrtar Ligjor pranë kësaj Dhomë, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe AKP-së.

Rrjedhimisht, mbi gjendjen e këtyre dëshmime materiale, rrjedhë së kandidatet e sipërshënuara kanë plotësuar kriteret formale për pozitën përkatëse, e duke qenë së të njëjtat kanë rezultuar si kandidate me më shumë pikë të arritura të vlerësimit, atëherë, Komisioni i Pranimid me të drejtë i ka shpallur edhe si kandidate fituese për pozitën Zyrtar Ligjor në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme, sikurse parashihet më nenin 23, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimid, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

II. Gjykata Themelore në Prishtinë

-Kandidatja D.K. posedon diplomën më nr.8362, të datës 29.03.2023, për përfundimin e studimeve bachelor më datë 02.12.2022, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Lidhur më përvojën e punës zotëron Certifikatën më numër protokolli 878/2024, të datës 21.10.2024, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më të cilën konfirmohet përfundimi i praktikës gjyqësore pranë kësaj gjykatë në kohëzgjatje prej 23.10.2023 deri 24.10.2024.

- Kandidatja Z.K. posedon diplomën më nr. 810/45-64, të datës 17.09.2024, për përfundimin e studimeve themelore në Programin Juridik, Kolegji “UBT”, ndërsa, përkitazi më përvojën e punës posedon Kontratën

më numër protokolli P/05/2024, të datës 28.10.2024, për punë praktike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për periudhën 28.10.2024 deri 27.10.2025.

-Kandidatja T.H. posedon diplomën me nr.8532, të datës 06.09.2023, për përfundimin e studimeve themelore më datë 29.06.2023, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Si dëshmi lidhur me përvojën e punës ka deponuar Certifikatën nr.prot:163/25, të datës 11.03.2025, për përfundimin e Praktikës Gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në kohëzgjatje prej një viti gjegjësisht nga data 12.03.2024 deri 11.03.2025, si dhe Vërtetimin më nr.prot: 925/25 të datës 17.11.2025, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më të cilin vërtetohet se kandidatja T.H nga data 05.05.2025, është e punësuar pranë kësaj gjykate në pozitën Zyrtare Ekzekutive.

-Kandidatja E.H. posedon diplomën më nr.4885, të datës 14.09.2017, për përfundimin e studimeve themelore më datë 22.06.2017, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Lidhur përvojën e punës ka bashkangjitur si dëshmi Vërtetimin e datës 30.09.2019, të lëshuar nga USAID/SSP, më të cilin vërtetohet se kandidatja E.H. nga tetori 2018 deri mars 2019 ka qenë praktikante gjyqësore, ndërsa, nga marsi 2019 deri 30 shtator 2019, ka qenë e angazhuar si Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë sipas Projektit të USAID-Programi për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë, si dhe Vërtetimin e datës 02.08.2021, të lëshuar nga biznesi LM Consulting, më të cilin dëshmohej se ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij biznesi nga data 12.10.2020 deri me date 06.08.2021, në pozitën Drejtoreshë Menaxhues, përvojë të cilën e ka mbështetur edhe më pasqyrë të Trustit Pensional.

-Kandidatja E.A, posedon diplomën më nr. 8993, të datës 19.07.2024, për përfundimin e studimeve themelore më datë 28.06.2024, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Ndërsa, përkitazi më përvojën e punës posedon Certifikatën më nr.prot: 828/25, të datës 24.10.2025, më të cilin vërtetohet përfundimi i punës praktike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për periudhën 28.10.2024 deri 27.10.2025.

-Kandidatja E.B, posedon diplomën më nr.520 të datës 22.10.2018, për përfundimin e studimeve themelore më datë 12.10.2018, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Ukshin Hoti”. Përkitazi më kriterin e përvojës së punës ka proceduar si dëshmi Certifikatën e datës 28.02.2020, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prizren, e me të cilën dëshmohej se e njëjta ka kryer praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prizren, nga data 01.03.2019 deri më datë 28.02.2020. Kandidatja E.B. posedon edhe përvojë tjetër praktike e cila për kolegjin ishte jo relevante, pasi që në kuptim të nenit 16, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, puna dhe angazhimi praktik konsiderohet përvojë pune pas diplomimit në kohëzgjatje vetëm prej një (1) viti.

-Kandidatja L.RR, posedon diplomën më nr.8951 të datës 17.07.2024, për përfundimin e studimeve themelore më datë 02.07.2024, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Përkitazi më kriterin e përvojës së punës ka bashkangjitur si dëshmi Certifikatën më nr.prot: 836/2025, të datës 24.10.2025, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën dëshmohej se e njëjta ka përfunduar praktikën gjyqësore pranë kësaj gjykate për periudhën 28.10.2024 deri 27.10.2025.

-Kandidatja B.G, posedon diplomën më nr.7705 të datës 27.10.2021, për përfundimin e studimeve themelore më datë 27.09.2021, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Përkitazi më kriterin

e përvojës së punës ka proceduar si dëshmi Certifikatën më nr.prot: 276/2025, të datës 21.10.2024, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se e njëjta ka përfunduar praktikën gjyqësore pranë kësaj gjykate për periudhën 24.10.2023 deri më datë 23.10.2024.

-Kandidatja A.R, posedon diplomën më nr.9075 të datës 11.09.2024, për përfundimin e studimeve themelore më datë 02.07.2024, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Ndërsa, përkitazi më përvojën e punës ka deponuar si dëshmi Certifikatën më nr.prot: 821/25, të datës 24.10.2025, me të cilin vërtetohet përfundimi i punës praktike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për periudhën 28.10.2024 deri 27.10.2025.

-Kandidatja F.A, posedon diplomën më nr.8460 të datës 20.07.2023, për përfundimin e studimeve themelore më datë 27.06.2020, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Ndërsa, përkitazi më përvojën e punës posedon Certifikatën më nr.prot: 886/24, të datës 21.10.2024, me të cilin vërtetohet përfundimi i punës praktike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për periudhën 24.10.2023 deri 23.10.2024.

-Kandidatja, A.Ç. posedon diplomën më nr.997 të datës 12.12.2023, për përfundimin e studimeve themelore më datë 01.11.2023, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Ukshin Hoti”. Përkitazi më kriterin e përvojës së punës ka proceduar si dëshmi Certifikatën e datës 01.03.2025, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prizren, e me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prizren, nga data 01.02.2024 deri 30.09.2024 dhe nga 01.11.2024 deri më 28.02.2025.

- Kandidatja M.G. posedon diplomën më nr.8037 të datës 20.07.2022, për përfundimin e studimeve themelore më datë 01.07.2022, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Ndërsa, përkitazi më përvojën e punës posedon Marrëveshjen për Fillimin e Punës tek Noteri Sefedin Blakaj, në pozitën bashkëpunëtorë profesionale, në kohëzgjatje 01.10.2024 deri më 31.12.2025, përvojë të cilën e mbështet edhe më Pasqyrë të Trustit.

-Kandidatja J.R-I. posedon diplomën më nr. 1546/23, të datës 02.08.2023, për përfundimin e studimeve themelore më datë 01.07.2022, në Programin Juridik i Përgjithshme, Kolegji “AAB”, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës ka të bashkangjitur si dëshmi shkresën më titull Konfirmim, nr.858/2025, të datës 24.11.2025, të lëshuar nga Drejtoresha Ekzekutive e Odes së Avokateve të Kosovës, me të cilin dëshmohet se ka kryer praktiken në zyrën e avokatit Mehmet Llabjani, me seli në Ferizaj, në periudhën kohore nga data 16.12.2023 deri me datë 15.12.2024.

-Kandidatja T.J. posedon diplomën me nr.8986, të datës 19.07.2024, për përfundimin e studimeve themelore më datë 28.06.2024, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”. Përkitazi më kriterin e përvojës së punës ka proceduar si dëshmi Certifikatën Agj. nr.436/2025, të datës 30.10.2025, të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, e me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer praktikën gjyqësore në këtë gjykatë, në kohëzgjatje prej një viti rrjedhimisht nga data 25.10.2024 deri 24.10.2025.

-Kandidatja L.M-SH, posedon diplomën me nr.479, të datës 20.09.2018, për përfundimin e studimeve themelore më datë 17.09.2018, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Ukshin Hoti”. Përkitazi më kriterin e

përvojës së punës ka deponuar si dëshmi Vërtetimin Vr.nr.1597, të datës 09.12.2019, të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i Odës së Avokateve të Kosovës, e me të cilën dëshmohet së kandidatja ka kryer praktikën në zyrën e avokatit Naim Spahiu, nga data 09.12.2018 deri më datë 08.12.2029.

Rrjedhimisht, mbi gjendjen e këtyre dëshmive materiale, rrjedhë së kandidatet e sipërshtënuara kanë plotësuar kriteret formale për pozitën përkatëse, e duke qenë së të njëjtat kanë rezultuar si kandidate me më shumë pikë të arritura të vlerësimit, atëherë, Komisioni i Pranimit me të drejtë i ka shpallur edhe si kandidate fituese për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sikurse parashihet më nenin 23, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kolegji i Këshillit referuar pozitës Zyrtar Ligjor në Gjykatën e Apelit, e në të cilin ankuesja ka aplikuar, nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së sipas Konkursit numër 03/2025 të datës 12.11.2025, për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën e Apelit kanë qenë të hapura dy vende, dhe atë një vend për komunitetin serb dhe një vend për komunitet më pak të përfaqësuar, dhe duke qenë se ankuesja sipas Dokumenti Personal të Identifikimit rezulton e shtetësisë kosovare, fakt ky i deklaruar edhe nga vet ankuesja në formularin e aplikimit të datës 18.11.2025, atëherë, më të drejtë SKGJK-a të njëjtën nuk e ka përfshi në listën e verifikimit paraprak dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe meqenëse nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale e karakterit procedural apo material dhe duke qenë së pretendimet ankimore nuk janë vërtetuar si të bazuara, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së procedura e pranimit sipas Konkursit të Jashtëm Nr.03/2025 të datës 12.11.2025, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ndërsa, lidhur me kërkesën e ankueses për qasje në testin me shkrim dhe vlerësimin, Kolegji rikujton palën ankuese së e njëjta bazuar në ligjin në fuqi për qasje në dokumente zyrtare ka zotëruar të drejtën që të kërkojë këtë dokument nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.328/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, B.M;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.